



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit datë 27.12.2022 dhe datë 28.12.2022.
2. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021, “Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 32, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar.
3. Mbi kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Kroi Mbret” sh.p.k. dhe shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a..
4. Mbi përfundimin e fillimit të procedurës nisur me vendimin e ERE-s nr. 89, datë 28.04.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k..
5. Mbi përfundimin e fillimit të procedurës nisur me vendimin e ERE-s nr. 112, datë 19.05.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec-i Tërvolit” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe shoqërisë “Hec-i Tërvolit” sh.p.k..